

AC-4653/14

C.nr.320/10

**GJYKATA THEMELORE NE FERIZAJ**, Departamenti i pergjithshem-divizioni civil, me gjyqtarin Enes Mehmeti dhe procesmbajtesen Minire Krasniqi, ne ceshtjen juridike te inicuar me padine e paditesit [REDACTED] nga fshati [REDACTED] komuna e Ferizajt te cilin e perfaqeson me autorizim av. [REDACTED] nga Ferizaj, kunder te paditures KS "Insig" me seli ne Prishtine, perfaqesuar nga [REDACTED] nga Prishtina, per kompensim demi, ne seancen e mbajtur me date 07.07.2014, ne pranine e perfaqesuesve te paleve ndergjygjese, me date 01.09.2014, merr kete:

### AKTGJYKIM

**PJESËRISHT APROVOHET**, si e bazuar, kërkesëpadia e paditësit [REDACTED] nga fshati [REDACTED]-Ferizaj, dhe **DETYROHET** e paditura Kompania e Sigurimeve "Insig" me slei ne Prishtine, qe paditesit ne ermër të dëmit jomaterial dhe material, të pësua në aksidentin e datës 14.05.2010, t'ia paguan shumat si vijojnë:

1. Në emër të dëmit jomaterial, për:
  - Përjetimin e dhimbjeve fizike shumën prej 3,500.00€, 1000
  - Përjetimin e frikes Shumen prej 2.500.00€, 500
  - Zvogëlimine aktivitetit jetësor Shumen prej 2,100.00€ 1100
2. Në emër të dëmit material, për:
  - Terapi fizikale Shumen prej 10.00€,
  - Per shpenzimit e mjekimit Shumen prej 54.90€,

, të gjitha këto me kamatën e cila do të llogaritet nga data 16.05.2014, e deri ne pagesën përfundimtare, sipas lartësisë që llogarisin bankar për deponimet e rëndomta të qytetarëve, të afatizuara për periudhën njëvjecare si dhe shpenzimet e procedures kontestimroe ne shume prej 833.00€, ne afat prej 15 ditesh pas plotefuqishmerise se ketij aktgjykimi, nen kercenimine eprnabrimit me dhune.

**REFUZOHET**, si e pabazuar, pjesa e kërkesëpadisë për shumën prej 2,400.00€, të kërkuar në emër të dëmit për te gjitha format e dëmit jomaterial si dhe shumen prej 560.00 të kërkuar në emër të dëmit marterial, per te gjitha format e dëmit material të kërkuara.

**OBLIGOHET** paditësi që të bëjë pagesën e tasksës gjyqësore për aktgjykim në shumë prej 50.00€, pas pranimit te këtij aktgjykimi mënjherë.

### Arsyetimi

Paditesi ne padi dhe ne theksimet e bera ne seancat e mbajtura, permes perfaqesuesit te tij, ka potencuar se paditesi si pasoje e aksidentit te dates 14.05.2010, ka pesuar lendime trupore dhe jotrupore, per te cilat pergjegjes, mbi bazen e rregullave te autorpergjegjesise eshte e paditura, dhe per lendimet e pesuara ne emer te demit material dhe jomateriual, kane parshtruar keresen ne lartesine e precizuar. I kane kekruar shpenimet e procedures.

10.10.2014

E paditura, permes perfaqesuesit te saj, ka kontestuar pjeserisht kerkesepadine epaditesit, perkitali me lartesine e shumave te pretenduara, duke potencuar ato si tejet te larta dhe jo ne harmoni me shkallen dhe antyren e lendimeve qe ka persuar paditesi.

Gjykata me qellim te vertetimit te drejte te gjendjes se fakteve te ceshtjes, ne baze te nenit 7.1 te LPK-se, ka bere adminsitrimin e provave si vijojne:

*Raporti I aksidentit, raportete specialistike, raporti I QE Ferizaj date 15.05.2010, raporti I QKUK QE Prishtine, raporti I qendren diagnostifikuese QKUK, raporti neurologjise, aktgjykimi I kesaj gjykate P nr 507/2010 date 21.07.2010, mendimi dhe konstatimi I eksperteve dr. [REDACTED] dhe Dr. [REDACTED], shiqimi I regjistimeve retngen.*

Gjykata pasi shqyrtoi dhe analizoi, provat e administruara, kete ne kuptim te nenit 8 te LPK-se, duke bere vleresiomine tyre vec e vec dhe te nderlidhura si teresi ka gjetur se kerkesepadia e paditesit eshte pjeserisht e bazuar.

Nga provat e amdinistruara, raporti I aksidentit dhe aktgjykimi penal, mund te vertetohet se pergjegjes per lendimet qe ka pesuar paditesi eshte e paditura mbi bazen e dispozitave te ligjit te aplikueshem per autopergjegjesine, andaj meqenese mes palëve ndërgjygjëse nuk ishte kontestuese baza juridike e padisëe, sepse në shkresat e lëndës ekzistojnë, prova të besueshme, që provojnë se janë plotësuar të gjitha elementet e ekzistimit te dëmit te shkaktuar me veprimin e paligjshëm të shkaktuesit të dëmit, lëndimet e shkaktuara nga fakti i paligjshëm, përgjegjësini e të paditurës mbi bazën e autopërgjegjësisi, per shkak se shkaktuesi I dëmit, në rastin konkret, ishte I siguruar te e paditura dhe faktin se si pasojë e veprimit të kundërligjshëm, të të siguruarit, të të paditurës, paditësit i është shkaktuar dëm material dhe jomaterial, dhe se e paditura ka detyrim për shpërblimin e këtij dëmi, ndaj dhe per kete gjykata ka gjetur se mes palëve ndërgjygjëse nuk ishte kontestuess fakti se e paditura kishte detyrimin dhe përgjegjësini civile në kuptim te nenit 173 lidhur me nenin 178 dhe nenit 940 te LMD-se, për shpërblimin e dëmit të pësuar - paditësit si pasojë e lëndimeve të marra nga aksidenti i datës 14.05.2010, andaj gjykata nuk ka dhënë vlerësimet e saja, posacerisht, lidhur me bazën juridike te pergjegesise civilo-juridike te te paditures sepse eshte e qarte se paditesi si pasoje e veprimeve te paligjshme te te siguruarit te te paditures, veprime keto qe tek paditesit kane shkatuar lendime te renda te shendetit ne e tyre, per te cilen gje sipas detyrimin mbi bazen e autopergjegjesise, e paditura eshte e obliguar t'ia shperbleje ne emer te ketyre lendimeve shperblimin e plote.

Nga mendimi dhe konstatimi I eksperteve dhe ate atij te ortopedise dhe psikiatriise rezulton si I verteuar fakti se paditesi ka pesaur lednimet te renda trupore me fraktura, si apsoje e te cilave ka perjetuar dhimbje fizike dhe zvogelim te aktivitetit jetesor per shkallen prej 3 % si dhe perjetim te frikes ne intenzitetin e pecaktuar. Mendimin dhe konstatimet e eksperteve gjykata e ka vlersuar si objektiv dhe professional dhe gjetjet e tyre i ka aprovuar sit e besueshme.

Gjykata ka vleresuar se percaktimi I vlerave te gjykuara ne emr te demit jomaterial eshte kompatibil me shkallen dhe natyren e lendimeve qe ka pesaur paditesit dhe se shumat e kerkuara pertej vlerave te aprvouara nuk eprkojne me qellimin e kompensimit te demit, si



statisfakcionmoral, andaj nga ajo që u parashtrua më sipër është evidente se paditëst ka pësuar dëm moral (pretium doloris ose pecunia doloris) për shkak të turbullimit të padrejtë të gjendjes shpirtërore si shfaqje e përkohshme e gjendjes së tyre shpirtërore e cila ka privuar ata nga aktivitetet e përditshmërisë jetësore dhe te punes, të cilat do t'i bënin po qe se nuk do t'u shkaktohej ky lloj dëmi, prandaj, gjykata ka vendosur, për shumat e gjykuara në bazë të nenit 323 te LPK-se lidhur me nenet 154, 187, 200 dhe 277 te LMD-se.

Gjykata ka refuzuar si te pabazuara pretendimet e paditesit per kompesnimin e demit ne emer te terapise fizikale pertej shumes prej 10.00€, ndersa ne teresi per kujdesin e personit te trete dhe ushqim te perforecuar , meqenese paditesi nuk ka arritur te ofroj prova material lidhurme shkaktimin e ketyre shpenzimeve.

Lidhur me kamaten, gjykata ka vendosur ne baze te nenit 277 lidhur me nenin 186 te LMD-se, ndersa pretendimi per lartesine e kamates prej 8%, eshte i pabazuuar meqenese aplikimi i Ligjit per sigurimin nga autopergjegjesi ka filluar pas dates se aksidentit.

Gjykata, obligoi te padituren, ne baze te nenit 452.1 te LPK-se, t'ia rimburoj shpenzimet e procedures kontestimore paditesve ne 3humen prej 833.00€, dhe ate per perfaqeism te avokatit ne tri séance Shumen prej 405.00€, per perpilimin e padise Shumen prej 78.00€precizimine padise Shumen prej 50.00€, per kompensim te eksperteve shumen prej 200.00€, per taksen gjyqesore per aktgjykim dhe apdi Shumen prej 100.00€, te gjitha keto sipas tarifges se OAK dhe UA 2008-2 te KGJK-se.

### GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ

C.nr.320/10 date 01.09.2014

Gjyqtari,

  
Mehmeti  


**UDHËZIMI JURIDIK:** Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në datë prej 15 ditësh pas pranimit të kopjes së tij, gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.

REPUBLIKA E KOSOVES  REPUBLIKA KOSOVA

VENDIMI ËSHTË I PLOTËDOR SHËM  
ODLUKA JE PRAVNOBESNA  
GJYKATA THEMELORE / ODRU NI SUD  
FERIZAJ II UROŠEVAC

-Ac.nr. 4653/14

Më  
Dana 06.11.2018

  
